

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës–Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Fillim Skoro anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.Z.ga fsh. ..., Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 4 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit, av. N.D. dhe av. A.K., si dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. G.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë P.nr.111/2017 të datës 16.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, më datë 04.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e pjesërishtë të ankesës së mbrojtësve të akuzuarit Sh.Z., NDRYSHOHET, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Pejë P.nr.111/2017 të datës 16.02.2018, vetëm për vendimin për dënim, ashtu që, Gjykata e Apelit, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, dënimin e shqiptuar me gjobë nga gjykata e shkallës së parë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, e merr si të vërtetuar, ndërsa, për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 4 KPRK-së, të akuzuarin I.R. e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjetësh, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga dt. 06.01.2017 e tutje.

Ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit Sh.Z., për bazat tjera ankimore, refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar në pjesën tjetër vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë P.nr.111/2017 të datës 16.02.2018, i akuzuari Sh.Z., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 4 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, dhe është gjykuar, për

veprën e parë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vjetësh, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim gjatë procedurës së ekstradimit prej dt. 06.01.2017

deri më datën 27.06.2017 dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.06.2017 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, si dhe për veprën e dytë penale me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dy mijë) €, dënim ky të cilin i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €. Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 150 €, kurse, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. G.H., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësit e të akuzuarit, av. N.D. dhe av. A.K., ankesë të përbashkët kanë paraqitur për shkak të vendimit për dënimin dhe vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet në rivendosje ose të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim.

Prokuroria e Apelit - Departamenti për Krime të Rënda, me parashtresën PPA/I.nr.157/2018, të dt. 13.04.2018, gjykatës i ka propozuar që ankesa e mbrojtësve të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën i ka njoftuar Prokurorin e Apelit, të dëmtuarit A.Th. dhe B.D., mbrojtësit e të akuzuarit av. G.H., av. N.D. dhe av. A.K. si dhe të akuzuarin Sh.Z.. Në seancën e kolegjit prezantuan i akuzuari Sh.Z. dhe mbrojtësi i tij av. G.H. dhe av. N.D., ndërsa edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit, të dëmtuarit A.Th. dhe B.D. dhe as mbrojtësi i të akuzuarit av. A.K., edhe pse ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt. Mbrojtësit e të akuzuarit av. N.D. dhe av. G.H., në seancën e kolegjit, pasi më parë, sqaruan disa nga pretendimet ankimore, duke arsyetuar secili veç e veç pretendimet e tyre ankimore, ngelën në tërësi pranë ankesave, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit av. N.D., propozoi gjithashtu, që për shkak të mos shqiptimit të masës për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik atëherë të anulohet aktgjykimi dhe i njëjti të kthehet në rivendosje ose të ndryshohet dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Me ankesën e mbrojtësve të akuzuarit, aktgjykimi i ankimuar nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mirëpo, Gjykata e Apelit, megjithatë të njëjtin – pra, aktgjykimin e ankimuar, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase, as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e vërtetuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit Sh.Z., për veprat e kryera penale, e në të cilat thirren në arsyetimin e aktgjykimin, e duke i vlerësuar të njëjtat – pra, rrethanat në fjalë përkitazi me pretendimet ankimore, kjo gjykatë i gjen si të bazuara pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit Sh.Z., për shqiptimin e dënimit më të butë me burgim se sa dënimet që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. G.H., përkitazi me vendimin për dënim, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe po ashtu me të drejtë ka konstatuar se nuk ka gjetur rrethana rënduese, mirëpo, duke pasur parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë qysh në fazën e parë të hetimeve, pastaj, konstatimin e përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar tek i akuzuari, e në anën tjetër dispozitat e nenit 76 të KPK-së, ku parashihen kufijtë e zbutjes së dënimit edhe nën minimumin e paraparë ligjor, atëherë, të akuzuarit ka pasur mundësi t'i shqiptohet një dënim shumë më i vogël se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, dhe atë në kohëzgjatje edhe prej 5 (pesë) vjetësh. Ndërsa, në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit av. N.D., dhe av. A.K., përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë si pranimin e fajësisë por edhe përgjegjësinë esencialisht të zvogëluar të akuzuarit, mirëpo në rastin konkret nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e parapara për zbutje të dënimit, ngase, kur është fjala për dispozitat në fjalë, nuk do të thotë që duhet doemos me respektuar kufijtë minimal dhe maksimal të dënimit të paraparë me ligj, ngase, ka mundësi që edhe nën kufijtë e paraparë me ligj t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim, prandaj, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 75 të KPK-së, atëherë, ka pasur mundësi që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, se në këtë çështje penale-juridike, nuk janë vlerësuar realisht rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe atë sidomos fakti se i akuzuari gjatë gjithë procedurë në këtë çështje penale-juridike, duke filluar, pra, qysh në fazën e parë të hetimeve ka pranuar fajësinë për veprat e kryera penale, pastaj, se i njëjti është penduar për një gjë të tillë dhe po ashtu, edhe publikisht i ka kërkuar falje familjeve të dëmtuara, pastaj, se përveç të akuzuarit edhe familjet e tyre janë pajtuar, ku të njëjtat, pra, familjet e dëmtuara nuk kanë parashtruar as kërkesë pasurore-juridike e duke marrë parasysh sidomos edhe faktin se i akuzuari veprën penale në fjalë e ka kryer nën ndikimin e aftësisë mendore të zvogëluar – gjegjësisht, nën përgjegjësi esencialisht të zvogëluar, atëherë, rezulton se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vjetësh, është i ashpër, çka me të drejtë pretendohet edhe me ankesa, prandaj, duke vlerësuar realisht rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit Sh.Z., për vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 4 të KPK-së, i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjetë, kurse, dënimin e shqiptuar me gjobë nga gjykata e shkallës së parë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, e merr si të vërtetuar, duke konsideruar, kështu, se tani dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga Gjykata e Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm, pastaj është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në

funksion të preventivës gjenerale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Gjykata e Apelit, mori parasysht edhe pretendimet ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal, kur të akuzuarit nuk i ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, mirëpo, pretendimet ankimore në fjalë janë të pa bazuara, ngase, përkitazi me masën në fjalë asnjëra nga palët nuk kanë kërkuar një gjë të tillë, ngase, sikur që vërtetohet nga shkresat në lëndë, në rastin konkret i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pranimin e fajësisë dhe nuk është lëshuar fare në procedimin e provave, gjë që, nuk ka pasur vërejtje as nga palët e as që është kërkuar procedimi i provave dhe shqiptimi i masës në fjalë, ndërsa, bazuar në dispozitat e nenit 86 të KPK-së, gjykata e shkallës së parë, nuk është e detyruar të shqiptojë masën në fjalë, por e njëjta ka mundur ta bëjë këtë, kuptohet, përveç me propozimin e palëve edhe sipas vlerësimit të sajë, gjë që, në rastin konkret nuk ka konsideruar të domosdoshme shqiptimin e një mase të tillë, prandaj, edhe nuk mund të konstatohet se gjykata ka bërë shkelje të ligjit penal, kur nuk ka caktuar një masë të tillë, sikur, që pretendohet në ankesë.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.166/2018, të dt. 05.04.2018

Procesmbajtës,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2. Fillim Skoro

Kryetare e kolegjit,

Tonka Berishaj